

Ferizaj - Nga Fshat Tregtar në Qendër Urbane

#FerizajHistory

Rrugëtimi i Ferizajt Përmes Kohërave

12/06/1999

Në Ferizaj hynë forcat e
Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
dhe të NATO-s.

1998 – 1999

Ranë **58 dëshmorë, dhjetëra civilë shqiptarë**
u vranë, ndërsa u dogjën **mijëra shtëpi**.

Rritja e popullsisë ndër vite:

Vitet 1960 – 1970:

Vitet 1980 – 1990:

Vitet 2000:

Vitet 2010 – 2024:



Muzeu Historik



Biblioteka dhe Arkivat



Monumentet dhe Shtëpitë e
Historisë



Monumentet e UÇK-së



Rruga Hekurudhore

Një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e Ferizajt është ndërtimi i rrugës hekurudhore në fund të shekullit XIX-të, ku u bë një nyjë e rëndësishme transporti dhe një qendër tregtare e zhvilluar. Ky zhvillim fillestar ishte baza e transformimit të vendbanimit të vogël në një qytet të rëndësishëm.




Periudha e Zhvillimit

Në gjysmën e dytë të shekullit XX-të, Ferizaj përjetoi një zhvillim të madh industrial. Ndërtimi i fabrikave dhe uzinave industriale solli një rritje të madhe të ekonomisë lokale dhe krijoi shumë vende të reja pune. Ky zhvillim jo vetëm që kontribuoi në rritjen ekonomike të qytetit, por gjithashtu tërhoqi një numër të madh të banorëve nga zonat rurale përreth.



Rindërtimi (1998-1999)

Lufta e Kosovës (1998-1999) kishte një ndikim të madh në Ferizaj, ashtu si në pjesët tjera të vendit. Qyteti pësoi dëme të mëdha infrastrukturore dhe pati humbje njerëzore. Pas përfundimit të luftës në vitin 1999, filloi një periudhë intensive rindërtimi dhe zhvillimi. Ky proces i rindërtimit solli një rigjallërim të shpejtë të Ferizajt dhe shënoi fillimin e një epoke të re të zhvillimit dhe modernizimit.



Qëllimi i Drejtorisë:

- **Arkivimi dhe Kërkimi:** Mbledhja, arkivimi dhe studimi i burimeve historike ka për qëllim të përforcoj njohuritë dhe kuptimin e historisë së Ferizajt.
- **Edukimi dhe Ndërgjegjësimi:** Drejtoria në Ferizaj ka për qëllim ruajtjen, promovimin dhe edukimin lidhur me trashëgiminë historike të qytetit. Përmes programeve edukative, udhëtimeve të udhëhequra dhe publikimeve informative, synojnë të nxisin ndërgjegjësimin dhe njohuritë e komunitetit për rëndësinë e trashëgimisë historike.
- **Promovimi i Historisë së Ferizajt:** Publikimi i librave, broshurave dhe materialeve të tjera me përmbajtje historike, kanë për qëllim të promovojnë historinë dhe zhvillimin e Ferizajt.
- **Bashkëpunimi dhe Bashkëveprimi:** Bashkëpunimi me autoritetet lokale, institucionet arsimore dhe organizatat e tjera ka për qëllim të zhvilloj projekte dhe iniciativa për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë historike të qytetit.

Projekt i Përkrahur nga:
Drejtoria e Zhvillimit
Ekonomik dhe Turizmit
Ferizaj



www.visit-ferizaj.com